

---

## THE ROLE OF INVESTMENTS IN TOURISM – FOCUSED ON MUNICIPALITY OF PEJA

**Kushtrim Dreshaj**

[kushtrimdreshaj@hotmail.com](mailto:kushtrimdreshaj@hotmail.com)

**Fatmire Shala Dreshaj**

[Fatmire17@hotmail.com](mailto:Fatmire17@hotmail.com)

**Abstract:** Tourism investments are important factors for holding, building and developing a country's economy. In the term "investments" are meant money assets that are engaged in new economic objects, in reconstruction of existing facilities, in modernization, in adaptation, in substitution of the underlying assets that are in operation. Tourism as an activity appears only when a certain level of socio-economic development of a country is achieved. It is born and develops when conditions are created that people temporarily leave their permanent home and temporarily move to temporary residence to rest, entertain or other tourist motives. The birth and development of tourism is the result of certain factors, which further promote and enable this development. The circumstances that enabled the birth and development of tourism are considered factors of tourism development and are of different nature. An alternative to investment in tourism is eco-tourism. Ecotourism is the model of sustainable development of tourism, because it groups different types of tourism around the generalized natural environment. Tourism is a major component in economic growth and has a strong impact on the development of the country, taking into account the protection of natural and cultural heritage as a prerequisite for sustainable tourism. Foreign direct investment is the most effective way to create new jobs in Kosovo and create preconditions for sustainable economic growth in the future.

**Keywords:** Foreign investment, tourism and economic development, tourism methods, ecotourism, market power in tourism

## ROLI I INVESTIMEVE NË TURIZËM-ME FOKUS KOMUNA E PEJËS

**Kushtrim Dreshaj**

[kushtrimdreshaj@hotmail.com](mailto:kushtrimdreshaj@hotmail.com)

**Fatmire Shala Dreshaj**

[Fatmire17@hotmail.com](mailto:Fatmire17@hotmail.com)

**Abstrakt:** Investimet në turizëm janë faktorë të rëndësishëm për mbajtjen, ngritjen dhe zhvillimin ekonomik të një vendi. Me fjalën "investime" nënkuptojnë mjetet në para që angazhohen në objekte të reja ekonomike, në rekonstruim të objekteve ekzistuese, në modernizim, në adaptim, në zëvendësim të mjeteve themelore që gjenden në funksionim. Turizmi si veprimtari shfaqet vetëm atëherë kur të arrihet një nivel i caktuar i zhvillimit shoqëror-ekonomik i një vendi. Ai lind dhe zhvillohet atëherë, kur krijohen kushtet që njerëzit përkohësisht të lënë vendbanimin e tyre të përhershëm dhe përkohësisht të kalojnë në vendbanim të përkohshëm për të pushuar, për t'u argëtuar apo për motive tjera turistike. Lindja dhe zhvillimi i turizmit është rezultat i disa faktorëve të caktuar, të cilët më tej e nxitin dhe e mundësojnë këtë zhvillim. Rrethanat që mundësojnë lindjen dhe zhvillimin e turizmit quhen faktor të zhvillimit të turizmit dhe janë të natyrave të ndryshme. Një alternativë e investimeve në turizëm është eko-turizmi. Ekoturizmi është modeli i një zhvillimi të qëndrueshëm të turizmit, sepse ai grupon tipe të ndryshme të turizmit rreth njënocioni të përgjithshëm që është mjedisi natyror. Turizmi është një komponent madhor në rritjen ekonomike dhe ndikon fuqishëm në zhvillim të vendit, duke marrë parasysh, mbrojtja e trashëgimisë natyrore dhe kulturore që është një parakusht për turizmin e qëndrueshëm. Investimet e huaja direkte paraqesin mënyrën më efektive për të krijuar vende të reja të punës në Kosovë dhe për të krijuar parakushte për rritje të qëndrueshme ekonomike në të ardhmen.

**Fjalë kyçe:** Investimet e huaja, turizmi dhe zhvillimi ekonomik, metodat e turizmit, eko turizmi, fuqia në treg në turizëm.

### HYRJE

Menjëherë pas luftës, në fazën emergjente të rindërtimit të Kosovës frekuentimi i vizitave të afaristëve dhe investitorëve potencial ishte mjaft i madh. Vështrimi i situatës dhe trendëve të përgjithshme dhe të ringjalljes ekonomike dhe mundësive për të zhvilluar biznesit e tyre në punët emergjente për evitimin e pasojave të luftës, kryesisht furnizimi me materiale ndërtimi dhe artikuj të konsumit të gjerë dhe angazhimi në punët ndërtimore ishte motivi kryesor. Hulumtimi i mundësive potenciale për aktivitete më serioze afariste siç janë IJD ishte një motiv shtesë. Kontakte intensive ka pasur sidomos me pjesëtarë të Diasporës Kosovare e cila pas

shumë viteve ishte në pozitë të njihet me rrethanat e reja politike dhe ekonomike, dhe vizionet lidhur me krijimin e një partneriteti me firmat e vendit<sup>160</sup>.

Investimi është një term që është përdorur shpesh në fushën e ekonomisë, menaxhimit e biznesit dhe financave. Ndërsa paraja e investuar mund të thotë kursim, kursimet bëhen përmes konsumit të vonuar. Investimet mund të ndahen në lloje të ndryshme në bazë të teorive dhe parimeve të ndryshme. Klasifikimi i investimeve mund të bëhet sipas asaj se kujt i shërbejnë, në këtë aspekt, ato ndahen në:

a). *Investime ekonomike (investime kapitale), dhe*

b). *në jo ekonomike (për standardin shoqëror)*

Investimet në ekonomi përfshijnë deponimet në mjete, të cilat u shërbejnë veprimtarive ekonomike të ndërmarrjeve, siç janë ndërtesat afariste, pajisjet teknike (makina), stabilimente, mjete të transportit, etj. Kurse investime jo ekonomike të ndërmarrjeve përfshijnë ato objekte, të cilët kryesisht hyjnë në mjete të konsumit të përbashkët, siç janë objektet e kulturës, sportit, të shëndetësisë, kujdesit social, ndërtesa për banim, etj. Sipas strukturës teknike, investimet ndahen në këto elemente: pajisje, pajisje montazhi, objekte ndërtimore dhe përgatitje të kuadrove, si për organizata të bujqësisë, ngritjes së fermave të ndryshme, mbjellje të fidanëve për pyllëzim, pastaj për studime dhe hulumtime, si dhe për blerjen e patentave dhe licencave (të drejtave)

Investimet e huaja direkte paraqesin mënyrën më efektive për të krijuar vende të reja të punës në Kosovë dhe për të krijuar parakushte për mirë të qëndrueshme ekonomike në të ardhmen. Promovimi i investimeve duhet të përfshijë aktivitete të ndryshme për të tërhequr .

Këto aktivitete mund të jenë: seminare, panaire, ekspozita, shpërndarje e materialeve informuese përmes medimeve të ndryshme, projekte marketingu, etj. Dinamikën e zhvillimit në sektorin e turizmit, duhet të shohim si një nxitës të rritjes ekonomike, duhet parë nga një këndvështrim realist dhe konkret me qëllim që kjo nxitje ekonomike duhet vi nga shteti dhe politikat e saja të favorshme.

Një investim i huaj direkt në ekonominë e një vendi jep efektet e veta jo vetëm në strukturën teknike të prodhimit, por edhe në atë të menaxhimit dhe të organizimit të aktivitetit që ajo ndërmerr. Arsyet dhe nevojat për promovimin e investimeve janë të shumta si: konkurrenca për kapitalin e jashtëm apo barrierat gjuhësore, kulturore dhe gjeografike. Deri me tani, përvoja ndërkombëtare ka treguar se duhet të punohet vazhdimisht në përmirësimin e kushteve më qëllim të thithjes së investimeve të huaja, si dhe në ngritjen e mirëqenies ekonomiko-sociale të vendit.

Një nga definicionet më të pranueshme, mbi turizmin është dhënë nga autorët zviceran Kunziker dhe Krapf, definicioni i cili është njohur edhe nga Shoqata Ndërkombëtare e Ekspertëve të Njohurive Turistike (AIEST). “Turizmi është tërësi e marrëdhënieve dhe fenomeneve që lindin nga udhëtimet dhe pushimet e vizitorëve të një vendi, nëse me atë pushim nuk themelohet vendbanimi i përhershëm dhe nëse me atë pushim nuk është lidhur asnjë veprimtari pune e tyre”.<sup>161</sup> Turizmi është dukuri jetësore e shoqërisë njerëzore të shekullit XIX, stil i ri i jetës së periudhës së revolucionit industrial në Evropë, kurse hulumtimet shkencore dhe teorike në fushën e zhvillimit të turizmit kanë filluar të trajtohen në fund të shekullit XIX dhe të atij XX, atëherë kur turizmi fillon të masivizohet për arsye të pjesëmarrjes në udhëtimet turistike dhe përfaqësuesit e klasave të ndryshme kapitaliste. Është e sigurt që hapat e parë në fushëveprimet teorike të turizmit kanë qenë relevante për punimet shkencore statistikore e më vonë edhe nga fushëveprimet e propagandës turistike.<sup>162</sup> Në publikimet shkencore dhe profesionale të vendeve të zhvilluara turistike si dhe në dokumentet e organizatave ndërkombëtare, si: WTO, IATA, AFEST, etj. Turizmin e trajtojnë si industri. Mirëpo, duhet theksuar se me këtë nuk mendohet një industri klasike që merret me prodhimin e produkteve ose me përpunimin e lëndëve të para, sepse mjetet të cilat shfrytëzohen, format organizative, teknika dhe teknologjia e procesit të punës si dhe produkti turistik në asnjë mënyrë nuk përngajnë në atë që nënkuptohet industri.<sup>163</sup> Turizmi është element komplementar i mozaikut të kontribuuesve tjerë të zhvillimit si p.sh. bujqësia, peshkimi, prodhimi, tregtia, shërbimet dhe nuk është zëvendësim i tyre. Sipas Organizatës Botërore të Turizmit të Kombeve të Bashkuara (OBTKB) për shumë nga shoqëritë në zhvillim, turizmi është burim kryesor shkëmbimi ndërkombëtar i të ardhurave në masën nga 5% deri 10%, madje deri në 25% kontribuues në GDP-në e një shteti varësisht nga madhësia, niveli i zhvillimit dhe resurset natyrore në përgjithësi, sidomos për shtetet në zhvillim, ishujt e vegjël etj. ku turizmi është burimi kryesor i zhvillimit. Ndërsa kontributi i turizmit në GDP e shteteve të zhvilluara, përgjithësisht është më i vogël deri 2% siç informon kjo organizatë dhe raporte tjera zhvillimore. Ekzistojnë lloje të ndryshme turizmi si të veçuara apo ndërlidhura varësisht nga gjeografia dhe karakteristika tjera të një vendi si dhe kërkesat dhe nevojat e konsumuesve dhe ofruesve të shërbimeve turistike, tradita, e kaluara dhe e tanishmja e një shoqërie. Janë të njohur turizmi kulturor, sportiv, rural, malor, shëruar dhe termal, spiritual, pushime, rekreativ, biznes profesional, eksplorues, turizëm ngjarjesh që mbledh turist në një vend për atë ngjarje etj. Shumica e njerëzve preferojnë destinacionet që janë pranë, të tjerë udhëtojnë gjatë për të vizituar vende për arsye të ndryshme dhe një përfshirë për shërim, për det me diell, mal gjatë verës apo dimër për skijim, etj. Ndonëse nuk ka statistika të mirëfillta rreth numrit të turistëve, numri i bizneseve dhe ekonomive familjare

<sup>160</sup> Investimet e Jashtme Direkte në Kosovë, Riinvest 2002 fq.15

<sup>161</sup> Prof. Dr. Nexhat Muhaxheri, “Ekonomika dhe Menaxhmenti në Turizëm”, Prishtinë 2005. Fq. 5.

<sup>162</sup> Prof. dr .Ramiz Zeka “Marketingu në Turizëm dhe Produkti Turistik” (Ligjërata të autorizuara), Pejë 2010. Fq. 8

<sup>163</sup> Dr.Armand Krasniqi, “Administrimi i Shërbimeve në Turizëm dhe Hotelieri”, Pejë 2005. Fq. 106

turistike është duke u rritur në komunën e Pejës, veçanërisht ai malor që i takon rajonit turistik të Alpeve Shqiptare. Në bazë të hulumtimit në kuadër të hartimit të strategjisë, lidhur me gjendjen e bizneseve turistike në Rugovë dhe tek Drini i Bardhë, si dy zona me vlera të larta natyrore dhe turistike, rezulton se numri i bizneseve që ofrojnë shërbime turistike si: restorante, motele/hotele, fshatra turistike dhe shtëpi private është rreth 33 operatorë me kapacitet të përgjithshëm akomodues.

Përfitimet e zhvillimit të sektorit të turizmit në zhvillimin lokal të një vendi është ngritja e mirëqenies së popullatës lokale nga rritja ekonomike dhe përmeshja e nevojave ekonomike, sociale dhe mjedisore përmes zhvillimit të aktiviteteve të ndryshme ekonomike familjare dhe komerciale në sektorin e turizmit dhe të tjera të ndërlidhura me të si prodhimet bujqësore dhe blegtorale, artizanatet etj. të cilat realizojnë profit një pjesë të së cilit e dedikojnë në pagesën e punonjësve, investimeve kapitale në rritje të kapacitetit dhe kualitetit prodhues-shërbyes.

Industria ushqimore, hoteliere dhe ekonomia familjare në qytetin e Pejës përfitoi nga një numër i pa parë ndonjëherë më parë i të huajve që erdhën në vitin 1999 e më pas të cilët punonin në organizatat e huaja dhe misionin e përkohshëm të KB, OSBE, etj. Ata dhe familjet e tyre akomodohehin në shtëpitë private me qira dhe ndonjë hotel që kishte rifilluar veprimtarinë, përdornin shërbimet dhe produktet që ekzistonin, të tjera eksportoheshin. Deri më tani, numri i operatorëve turistik konsiderohet të ketë shënuar rritje rekorde në komunën e Pejës, ashtu edhe kapacitetet akomoduese dhe shërbyese.

### LLOJET E TURIZMIT PEJE

Peja, në të vërtetë, përbën një qendër të vjetër banimi. Peja si vendbanim daton që nga kohërat më të hershme Ilire, dhe ishte qyteti më i rëndësishëm i Dardanisë Antike. Në këtë lokalitet është zbuluar një numër objektesh arkeologjike, që na bëjnë edhe më bindës se këtu duhet të ketë qenë një qendër administrative komunale e tërë rrafshit të Dukagjinit.<sup>164</sup>

Peja në kohën antike dhe në mesjetë deri në shek XV shtrihej pikërisht në fushë duke filluar nga arat e quajtura, Gradinë”, ku janë gërmadhat e Pejës antike, d.m.th. Shtrihej nga tyrbja e, Sari Salltëkut” ku tani gjendet fabrika e baterive, në Lindje, e deri Te stacioni hekurudhor më saktë deri te kalaja, në Perëndim.

Turizmi është një nga e vetmja degë e ekonomisë që qysh prej vitit 2002 ka një strategji dhe politik koherente zhvillimi dhe master plan të shkallëzuar në etapa deri në vitin 2015.<sup>165</sup>

Pejen gjatë historisë e hasim me emra të ndryshëm si: në kohën antike Iliro-Romake është quajtur Siparantum, kurse gjatë mesjetës quhej: Pech (Pekë,P(j)ekë)), Peka, Pentza dhe Forno, Peja, e cila në dokumentet latine figuron në formë Pechi (1202), me sa dihet ky është dokumenti më i vjetër i ruajtur në atë kohë. Në atë kohë në Pejë ishte e zhvilluar tregtia. Aty ekzistonte Kolonia e Dubrovnikasve. Peja si Siparant Dardan përmendet në hartën: Gjeografi e Ptolemeut në shekullin III-IV (nën sundimin e romakëve) civilizimi i të cilit arrin shkallën më të lartë të lulëzimit, dhe ka pasur statusin e Municipiumit. Peja në atë periudhë historike bëhet një nga qytetet kryesore të Dardanisë pas Ulpianës (Prishtina e sotme). Peja me rrethinë pas betejës së Kosovës (1389) e deri më 1462 administrohej njëherë nga Balshajt (1378) e pastaj nga Dukagjinat... Historia e Pejës është e lidhur ngushtë edhe me familjen e Dukagjinave.Leka dhe Pali e qeverisnin vendin bashkërisht. Në kohën e luftës të Gjergj Kastriotit kundër perandorisë Osmane, deri me 1462 me këtë qytet sundonte Lekë Dukagjini III...

Duke u bazuar në terrenin në të cilin shtrihet Peja ka resurse të mëdha tërheqëse dhe interesante turistike të cilat mund ti kënaqin edhe adhuruesit e natyrës së egër të paprekur, por edhe adhuruesit e bukurive idilike fshatare, si dhe hulumtuesit e interesuar për gjurmë të së kaluarës.<sup>166</sup>Duke u shtrirë në mes të rrjedhës së lumenjve Drini i bardhë dhe Lumëbardhi, Peja ofron një spektër mundësish për peshkatari të llojeve fisnike të peshqve të ujërave të ëmbla, ndërsa adhuruesve të aventurave të sporteve dimërore dhe verore do t'u ndalet fryma nga bukuritë e kanjonëve, ujëvarave dhe terreneve të përshtatshme për skijim. Familjet me fëmijë dhe të hareshmit të padurueshëm për shijimin e shëtisë në flladin natyrorë do të gjejnë pushim ideal në brigjet e freskëta të lumenjve në ditët e nxehta të verës. Llojet e turizmit në komunën e Pejës Në bazë të terrenit dhe aktiviteteve turistike të tanishme dhe potenciale në komunën e Pejës mund të identifikohen këto lloje turizmi në nivele të ndryshme zhvillimi, specifikash, mundësish dhe nevojash si:

- turizmi malor i cili është më i përhapuri,
- bjeshkëtaria dhe ngjitje shkëmbinjsh
- turizmi I shpellave
- turizmi rural;
- turizmi kulturor për çfarë janë bërë shumë restaurime dhe investime mirëmbajtje objektsh kulturore të mbrojtura dhe të tjera si Çarshia, Mulliri i Haxhi Zekës etj.;

<sup>164</sup> www.kk.rks-gov.net/peje

<sup>165</sup> Plani Zhvillimor i Komunë së Pejës për Periudhën 2002-2015.

<sup>166</sup> www.peja-komuna.org

- turizmi sportiv si: ski, malor, fluturime me parashutë etj. nuk janë shumë të zhvilluara për shkak të kapaciteteve të limituara momentale, por që përbën një potencial për ofrimin diversifikimin e ofertës turistike;
- turizmi shërues përmes dy favoreve natyrore, njëri nga ta është qëndrimi për një periudhë kohore në lartësi të ndryshme mbidetare malore (sipas moshës dhe sugjerimeve të mjekut) që shërben për pushim rehabilitues dhe ndihmon në trajtimin e sëmundjeve, si dhe turizmi shërues me ujë termal në Banjë të Pejës që është në kufirin territorial me komunën e Istogut, por me karakter regjional, gjithëkombëtar dhe afër qendrës së Pejës;
- turizëm ngjarjesh të ndryshme kulturore etj. si festivalet, lojërat tradicionale rugovase, panairi vjetor i artizanateve dhe produkteve lokale, i turizmit etj

Këto aktivitete turistike dhe të tjera për t'u eksploruar së bashku përbëjnë një potencial turistik, një vlerë të shtuar dhe plotësojnë ofertën turistike në mënyrë komplementare me rëndësi për zhvillimin e qëndrueshëm të turizmit në komunën Pejë.

Hapësira e Pejës në përgjithësi është e mbuluar me male dhe maja të pasura me pyje gjetheramëse dhe gjethembajtëse të gjelbërta, të cilat në vete fshehin pasuri të paparë për gjuetar dhe për grumbullues të bimëve mjekuese. Peja është e pasur me kushte të cilat ofrojnë mundësi për zhvillimin e turizmit të gjuetisë. Rezervat më të njohura të Fondit të shtazëve janë në Rezervatin e Rusolisë si: Gjahu i lartë: Ariu, Kaprolli, Derri, Dhelpra, Cjapi i egër, Rrëqebulli, Kunalja e artë, Kunalja e bardhë etj. Gjahu i ultë: Lepuri, Thëllëza, Fazani, Pula e egër, Gjeli i pyjeve etj. Bimët mjekuese që gjinden në alpet shqiptare janë: (kantaroni-hypericum perforatum; lulja e gjuhëtit– thymus serpyllum; “Pustikara”- dignalis feruginea; mjekra e dhisë -Aruncus silvestris kost; lule boronica, lule aguliqe, lule kamamili etj). Dhe prodhimet malore ,(boronica , dredhëza, mjedra, këpurdha , manaferra, thana, lajthia etj). Klima malore e regjionit të Rugovës me verën e nxehtë e dimrin e ftohtë dhe të gjatë, favorizon pa rezervë turistët që atje të thithin ajrin e pastër, me jone të zbritura nga Mali në mëngjesin e hershëm deri në orën nëntë që janë stimulues për shëndetin e njeriut. Jo vetëm ajri i pastër por edhe larmia e botës së gjallë që të humb në mendim e meditim, të kthesh në origjinën tënde si njeri, të gjykosh se çfarë je ti sot, cili është dallimi në mes teje dhe gjithë asaj bote kafshësh të buta e të egra, zogjsh e insektesh që janë në harmoni në mes vete dhe me atë që i rrethon natyrën. Prania e ujërave është vendimtare për çdo turizëm, andaj regjioni konsiderohet si rezervar ujërash me prurje optimale nga lumenjtë e thellë që i japin pamje estetike, shenjat ujëvarat, puset e gurrat, si në numër ashtu edhe në përhapje të konsiderueshme. Uji i tyre është i kthjelltë si kristal, në të shumtën e rasteve i ftohtë por i pasur me peshkun e shijshëm –Trofta. Si do që të jetë regjioni i Rugovës mbetet një vend me klimë të përshtatshme për verime , në përgjithësi me verë të freskët ku temperaturat shkojnë deri në 17.2 gradë Celsius e ndonjëherë deri 20 e 25 gradë C që favorizon turizmin shtëpiak, të organizuar stacionar, shërues, dhe sportivo -rekreativ si , ngjitje dhe marshim, shëtitje, vizita monumenteve kulturo - historike lëshim me parashuta, , notim në liqenin e Liqenatit dhe lundrim në lumë. Ndërsa dimri i ftohtë dhe i përshtatshëm favorizon zhvillimin e turizmit dimëror, ski, ngjitje dhe atë stacionar.Motivin më të bukur dhe njëherit të veçantë paraqet Gryka e Rugovës dhe fusha rreth shtratit të Lumëbardhit të Pejës. Kreshtat shkëmbore të cilat i përbëjnë majet e bjeshkëve, shpatijet e gjelbëruara me barë,luginat e shumta pyjore, gryka dhe kanjonet atraktive, lumenjtë e pastër e të shkumbëzuar, ujëvarat, burimet dhe liqenet, janë përmbajtja e peizazhit të Alpeve shqiptare. Tërësi të posaçme atraktive të pejsazhit janë sipërfaqet më pyje dhe vegetacion të barit. Zonat pyjore janë të përbëra nga ahishtat, rropujt, molika, bredhi, dëllinja dhe llojet tjera zëvendësohen me zonat e vegetacionit të barit.